




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



Nr. I prot. 345 Më 04.04.2019
Br. prot. Dt. 04.04.2019

Duke u bazuar në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna dhe duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 582 i datës 27.02.2019 për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike, Kuvendi i Komunës së Rahovecit shpall:

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ të Ekspertëve për Shërbime Publike

1. Komiteti Konsultativ i ekspertëve për shërbime publike (7 anëtarë)

Pozita: Anëtar i Komitet Konsultativ të ekspertëve për Shërbime Publike.

Kompensimi: 50€ për një mbledhje (mbledhjet mbahen varësisht nga nevoja, por së paku duhet të mbahen 6 (gjashtë) takime në vit).

Mandati i anëtarit të Komitetit: 4 (katër) vjeçar.

Mbikëqyrja: Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Kompetencat:

- Jep mendime, propozime dhe vërejtje në propozimet e Kryetarit të Komunës lidhur me dokumentet e planifikimit në shërbime publike dhe dokumentet tjera të cilat i miraton Kuvendi i Komunës.
- Hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e Përhershme dhe Kuvendi i Komunës në fushën e Shërbimeve Publike.
- Paraqitja e mendimeve dhe pikëpamjeve të ndryshme të Kryetarit të Komunës dhe Kuvendi i Komunës për strategjinë zhvillimore në fushën e shërbimeve publike.
- Jep propozime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të identifikuara.
- Përcjell dhe kujdeset për procedurat të cilat duhet të kalojnë dokumentet dhe projektet e shërbimeve publike, a janë në pajim me dispozitat ligjore që miratohen nga Kuvendi i Komunës.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e Shërbime Publike.

Kushtet:

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit.
- CV
- Diplomë universitare në lëmin përkatës (e dëshirueshme), por edhe në lëmi tjera (Arkitekturë, Juridik, Ekonomi, Inxhinieri, etj).

- Të jetë njohës i mirë i fushës së Shërbimeve Publike.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Certifikata e lindjes.
- Kopja e letërnjoftimit.

Kandidatët e interesuar për aplikim, aplikacionet mund ti marrin dhe ti dorëzojnë në Zyrën e pranimit në Objektin e ri të Komunës, Kati i Parë

Afati i konkursit: Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes

Aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato të cilat arrijnë pas afatit nuk do të merren parasysh.

Përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit bëhet nga Paneli përzgjedhës i caktuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit ofron mundësi të barabarta të anëtarësimit në Komitetet e Kuvendit Komunal për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha Komitetet e Komunës së Rahovecit



A circular official stamp of the Municipality of Rahovec, Kosovo. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top and "RAHOVEC" at the bottom. Inside the ring, it says "Kuvendi i Komunës së Rahovecit". In the center is a shield with a sun and stars. To the right of the stamp is a handwritten signature in black ink. Below the signature, the name "Afrim Dina" is printed, followed by the title "Kryesues i Kuvendit" (Chairman of the Assembly).